

Dr. Muhamet SHATRI, Prof. Dr. Ramiz ABDYLI, “Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1911-1912”, Libri II, Instituti i Historisë-Prishtinë, 2004, 501 f.

Monografia më e re e Prof. dr. Ramiz Abdylit është rezultat i një pune hulumtuese kërkimore shumëvjeçare dhe përbën interes të veçantë për historiografinë tonë dhe më gjerë. Ajo shënon arritje në historiografinë shqiptare: në pikëpamje metodologjike dhe për nga struktura; për gamën e gjerë të ngjarjeve dhe të personaliteteve historike të trajtuara dhe për të cilat është shfrytëzuar një dokumentacion i pasur, që vjen nga burime të shumta arkivore e bibliografike (shqiptare, osmane, bullgare, serbe, franceze, angleze, serbe, bullgare dhe malazeze); për fondet shfrytëzuara e të karakterit gjithëpërfshirës që trajtojnë me objektivitet e me vërtetësi shkencore ngjarje dhe personalitete nga të gjitha krahinat etnike shqiptare, shpesh të patrajtuara më parë.

Për nga struktura, monografia është e ndarë në 9 kapituj, shoqërohet me përfundimet në gjuhët shqipe e angleze, me burimet dhe literaturën e shfrytëzuar dhe me treguesin e emrave.

Na kaptinën e parë, “Përgatitja dhe shkaqet e Kryengritjes së vitit 1911”, autori i monografisë trajton në mënyrë të argumentuar kushtet që nxitin përgatitjet dhe shpërthimin e Kryengritjes së vitit 1911. Në bazë të dokumentacionit të shfrytëzuar ai nënvizon se kryengritja u organizua nga drejtuesit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Ata hartuan planin e fillimit të kryengritjes që do të shpërthente në Vilajetin e Shkodrës dhe atë të Kosovës dhe që do të shtrihej më pas në vilajetet e Manastirit e të Janinës; miratuan qendrën e drejtimit dhe përcaktuan objektivin e saj që ishte realizimi i autonomisë së Shqipërisë në kuadër të Perandorisë Osmane. Organizatorët vlerësonin se numri i madh i refugjatëve, i pjesëtarëve dhe i drejtuesve të Kryengritjes së vitit 1910 që u vendosën në Mal të Zi, nga vjeshta e atij viti, do të përbënin bazën për fillimin e kryengritjes. Por përpjekjet e tyre për të bashkëpunuar e bashkërenduar aksionet me lëvizjet e popujve të tjerë të nënshtuar në Perandorinë Osmane dhe sidomos me Lëvizjen Kombëtare Maqedonase dështuan, për shkak të pengesave të qarqeve drejtuese të Sofjes të cilat dirigjonin një krah të asaj lëvizjeje. Ndërkohë, fqinjët e tjerë ballkanikë synonin ta përdornin kryengritjen shqiptare si mjet për realizimin e pretendimeve territoriale ndaj trojeve shqiptare. Organizatorët e kryengritjes bënë përpjekje për të siguruar mbështetjen e ndonjëres prej Fuqive të Mëdha të interesuar për Shqipërinë, por edhe këto përpjekje nuk patën sukses, sepse ata konsideronin se shpërthimi i kryengritjes shqiptare ishte i parakohshëm dhe se ajo binte ndesh me interesat e tyre strategjike në Ballkan. Në vazhdim, autori provon se në mbështetje të kryengritjes u vu diaspora shqiptare, sidomos arbëreshët e Italisë, të cilët punuan për propagandimin e aspiratave të shqiptarëve, për sigurimin e mjeteve materiale dhe për organizimin e

vullnetarëve arbëreshë e italianë për të luftuar përkrah kryengritësve. Rrjedhje e këtyre përpjekjeve ishte edhe krijimi i një grupimi brenda parlamentit italian, me në krye Richioti Garibaldin, i cili mbështeti kryengritjen.

Kapitulli i dytë. “Shpërthimi i kryengritjes dhe rrjedhjat e saj”. Nxjerr në pah planet e Qeverisë së Malit të Zi për të vënë nën kontroll Kryengritjen shqiptare të vitit 1911, që ajo u përpoq ta realizojë nëpërmjet komprometimit të ndonjërit prej drejtuesve të saj. Por këto përpjekje të qeverisë malazeze dështuan dhe për këtë arsye ajo kërkoi në mënyrë ultimative largimin nga Mali i Zi të Isa Boletinit dhe të refugjatëve shqiptarë të strehuar në atë vend, çka nxiti shpërthimin e parakohshëm të kryengritjes. Kryengritësit në Malësinë e Mbishkodrës u detyruan të hynin në luftë, ndonëse ishin të papërgatitur, me armatim të pakët dhe nuk kishin arritur të bashkërendonin aksionet me viset e tjera. Isa Buletini pas largimit nga Mali i Zi kaloi në Vilajetin e Kosovës dhe u përpoq për organizimin e kryengritjes së armatosur.

Nëpërmjet dokumentacionit të shfrytëzuar autori nënvizon se përlëshjet ndërmjet kryengritësve të paarmatosur e pa asnjë ndihmë nga jashtë dhe trupave osmane, shumëfish më të mëdha dhe me epërsi në armatime, në ndihmë të të cilave erdhën përforsime të mëdha të komanduara nga gjenerali famëkeq Shefqet Turgut pasha, vijuan për gati tre muaj, ato ishin të përgjakshme dhe kryengritësit treguan një heroizëm të rrallë. Po këtu, autori evidencon dobësinë e drejtuesve të Lëvizjes Kombëtare që nuk arritën të organizonin, sipas parashikimeve, një kryengritje të përgjithshme dhe faktin se përlëshjet sporadike të çetave në viset e tjera dhe kryengritja në Vilajetin e Janinës nuk arritën të përbushnin objektivin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Një vend të veçantë në këtë kapitull zë trajtimi i programit politik të lëvizjes që u shpreh nëpërmjet memorandumit të Greçës, në të cilin u kërkua autonomia e Shqipërisë, si edhe me kërkesat e ngjashme që u shtruan në Manastirin e Cepos nga drejtuesit e çetave kryengritëse dhe të Lëvizjes Kombëtare në Shqipërinë e Jugut.

Autori konstaton se forcat osmane, përkundër epërsisë që kishin, nuk arritën të shtypnin kryengritjen shqiptare në Malësinë e Mbishkodrës, ndërsa synimet e qeverisë malazeze për përfitime territoriale në kurriz të tokave shqiptare ndikuan në acarimin e marrëdhënieve osmano-malazeze. Për të ndaluar shpërthimin e një konflikti të ri të armatosur u detyruan të ndërhyjnë Fuqitë e Mëdha të cilat i kërkuan qeverisë osmane të riatdhesonte refugjatët shqiptarë dhe të hynte në bisedime me drejtuesit e kryengritjes. Qeveria osmane në marrëveshjet e veçanta që lidhi, në Podgoricë, me drejtuesit e kryengritjes së Malësisë së Madhe dhe në Tepelenë, me ata të Shqipërisë së Jugut, u garantonte dy krahinave disa të drejta, që ishin shumë të kufizuara krahasuar me kërkesat e shtruara në memorandumet e Greçës dhe të Cepos.

Në kreun III, “Lëvizja Kombëtare Shqiptare gusht-dhjetor 1911”, autori ndalet në shkaqet që i detyruan drejtuesit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për përgatitjen dhe fillimin e kryengritjes së re kundërosmane. Ai argumenton se në themel të pakënaqësisë ishin qëndrimet mospërfillëse dhe mosgatishmëria e qeverisë xhonturke për të zgjidhur statusin e popullit shqiptar. Edhe në këtë rast nuk reshtën,

por pa rezultat, përpjekjet për të siguruar mbështetjen e ndonjëres prej Fuqive të Mëdha, si dhe bashkëpunimin me lëvizjet e popujve tjerë të nënshtruar të Perandorisë Osmane dhe sidomos me lëvizjen maqedonase. Ndërkohë, komitetet e fshehta që u angazhuan për organizimin e kryengritjes së armatosur i shtuan përpjekjet, sepse gjykonin se lufta italo-osmane në Libi dhe kryengritja nacionalçlirimtare në Jemen, përbënin një rrethanë lehtësuese për suksesin e saj.

Kapitulli i katërt i monografisë trajton shpërthimin e Kryengritjes së përgjithshme të armatosur të vitit 1912. Autori i monografisë, për dallim nga studiues të deritashëm, fillimin e saj e zhvendos në fund të janarit 1912, kur nisin veprimet e çetave kryengritëse të armatosura në Rrafsh të Dukagjinit dhe në Malësi të Gjakovës. Ai ndalet në parapërgatitjet dhe në fazën e parë të kryengritjes së përgjithshme; në përpjekjet e dështuara të qeverisë osmane për të penguar shpërthimin e saj; në përbuzjen, urtejten, madje edhe në pritjen me armë në disa vise të të ashtuquajturit Komision i Reformave me Haxhi Adil beun në krye dhe në dështimin e veprimtarisë së tij në Shkup, Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Shkodër, Dibër, Manastir e kudo në Shqipëri; në veprimet e para që u zhvilluan gjatë majit të vitit 1912 për të përhapur zjarrin e kryengritjes në Malësinë e Gjakovës, në Rrafshin e Dukagjinit dhe që vijuan me veprimtarinë e çetave të armatosura në Malësinë e Dibrës, të Strugës, Kërçovës, Krushevsë e të Prilepit; në parregullsitë e zgjedhjeve parlamentare, që përfunduan në dëm të kandidatëve atdhetarë dhe me fitoren e shumicës së kandidatëve xhonturq, veprime këto që çuan në përkeqësimin e mëtejshëm të marrëdhënieve shqiptaro-xhonturke.

Në kapitullin “Zhvillimi i kryengritjes së armatosur maj qershor 1912 dhe Lëvizja e Oficerëve” provohet se nga fillimi i majit 1912 drejtuesit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare me Hasan Prishtinën u vunë në ballë të kryengritjes së armatosur dhe u bënë udhëheqësit e drejtuesit e saj. Ata përpunuan platformën politike të kryengritjes e cila u shpалos në gjysmën e dytë të majit 1912, në Kuvendin e Junikut, ku u shtrua kërkesa programore e kryengritjes, realizimi i autonomisë së Shqipërisë. Më tej, autori konstaton se gjatë gjithë muajit qershor pati përlëshje të armatosura midis çetave të vogla shqiptare dhe forcave të ushtrisë e të xhandarmërisë osmane në viset veriperëndimore të Vilajetit të Kosovës, të cilat nuk gjetën mbështetje nga drejtuesit e Lëvizjes Kombëtare në viset e Shqipërisë së Mesme dhe në Shqipërinë Jugore.

Një moment me rëndësi në Kryengritjen e përgjithshme antiosmane të vitit 1912 sipas autorit përbën dalja në skenën politike të Perandorisë Osmane e lëvizjes në ushtri, apo Lëvizja e Oficerëve, e cila u përpoq për rrëzimin e regjimit të Turqve të Rinj dhe për realizimin e këtij qëllimi hyri në lidhje edhe me drejtuesit e kryengritjes shqiptare. Sipas autorit, një rol shumë të rëndësishëm për bashkëpunimin e dy lëvizjeve e luajtën oficerët shqiptarë me në krye Tajar bej Tetovën, të cilët u inspiruan nga motive kombëtare. Për rrjedhojë, më 22 qershor dezertimet nga Truparmata e Manastirit u pasuan edhe me dezertimet nga radhët e truparmatave të tjera në pjesën evropiane të perandorisë. Shumica e oficerëve dhe ushtarëve që dezertuan ishin shqiptarë dhe ata u bashkuan me çetat kryengritëse në viset shqiptare dhe sidomos në Shqipërinë Jugore. Këto dezertime u pasuan edhe

nga nëpunësit e ulët e të mesëm të administratës vendore, çka i dha kryengritjes së përgjithshme antiosmane dimensione dhe një hov të ri. Kjo frymë, sipas autorit të monografisë, erdhi në shprehje sidomos në Vilajetin e Kosovës, atë të Shkodrës dhe në një pjesë të Vilajetit të Manastirit, ndërsa çetat në Shqipërinë Jugore edhe më tej luanin me kartën e pritmerisë.

Në kapitullin e pestë "Shpërthimi i kryengritjes së armatosur dhe shtrirja e saj", jepen të dhëna për sukseset e njëpasnjëshme, në fund të qershorit dhe fillim të korrikut të vitit 1912, të kryengritësve shqiptarë në Vilajetin e Kosovës. Pas suksesit të kryengritësve në Qafë të Prushit, pasoi çlirimi i Gjakovës, ndërsa më 17 korrik 1912, qeveria xhonturke u detyrua të jepte dorëheqjen. Në këto rrethana, sultan Mehmet Rashiti V autorizoi një komision qeveritar me Ibrahim Pashën në krye, për të hyrë në bisedime me drejtuesit e kryengritjes. Ndërkohë deri në fund të korrikut u çliruan njëri pas tjetrit të gjitha qytetet e Kosovës dhe kryengritësit bënë "zotërit absolut të situatës" në veri të Grykës së Kaçanikut.

Autori ndalet në bisedimet shqiptaro-osmane ë zhvilluara në Prishtinë dhe në mospajtimet midis kabinetit qeveritar dhe drejtuesve të kryengritjes me Hasan Prishtinën në krye. Për t'iu kundërvënë kërkesave të drejtuesve të kryengritjes dhe të H. Prishtinës, qeveria osmane dërgoi në Prishtinë një Këshill të përfaqësuesve të qyteteve të Vilajetit të Kosovës me në krye Mehmet pashë Derallën. Përçarjet midis drejtuesve të kryengritjes dobësuan pozitat e krahut atdhetar të H. Prishtinës, ndërkohë që disa drejtues të shquar të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, si Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi, etj. nuk e panë të arsyeshme të udhëtonin për në Kosovë, por nuk ngulmuan as për përhapjen e zjarrit të kryengritjes së përgjithshme në Shqipërinë Jugore. Në bisedimet shqiptaro-osmane që filluan në Prishtinë, në fund të korrikut 1912, H. Prishtina shtroi kërkesa me karakter kombëtar, të ngjashme me ato të Kuvendit të Junikut, që synonin realizimin e autonomisë territoriale-administrative të Shqipërisë. Autori nënvizon se në këto çaste vendimtare për fatin e atdheut, H. Prishtina iu drejtua forcave atdhetare të katër vilajeteve që të dërgonin përfaqësuesit e tyre në bisedime. Por, kjo pjesëmarrje nuk u arrit për shkak të zhvillimit të shpejtë të ngjarjeve, si dhe të veprimtarisë përçarëse e të presionit të Komisionit qeveritar mbi grupimin atdhetar në gjirin e drejtuesve të kryengritjes.

Por pavarësisht nga këto, të dy grupimet arritën në kërkesën e përbashkët për shpërndarjen e parlamentit, gjë që nuk u miratua nga Komisioni qeveritar dhe kjo i detyroi kryengritësit që në fillim të korrikut t'i drejtoheshin Ferizajt dhe rrethinës. Në Ferizaj H. Prishtina, i mbështetur vetëm nga një pjesë e drejtuesve të kryengritjes, u detyrua të hartonte e të paraqiste 14 kërkesa, të cilat ishin nën nivelin e kërkesave të mëparshme. Kërkesat e formuluar në formë ultimatumit iu dorëzuan Komisionit qeveritar, të cilit iu bë e qartë se nëse ato nuk do të plotësoheshin brenda 48 orëve, kryengritësit do të marshonin drejt Shkupit.

Po në këtë kapitull, autori ndalet në fillimin e veprimtarisë e të çetave të armatosura në Shqipërinë e Jugut, si dhe në kërkesat e paraqitura prej tyre në Kuvendin e Gjirokastrës. Në telegramin që kërret e kryengritjes e të Lëvizjes Kombëtare të krahinave të jugut i dërguan kabinetit osman, kërkohej që të drejtat të cilat do t'i njiheshin Vilajetit të Kosovës duhej të shtriheshin në katër vilajetet

shqiptare. Më 10 gusht, Komiteti kryengritësi Shqipërisë së Mesme e autorizoi H. Prishtinën për t'i përfaqësuar në bisedimet me Komisionin qeveritar.

Në kapitullin "Memorandumi i Ferizajt dhe Marrëveshja shqiptaro-osmane e Shkupit", theksohet se, meqë qeveria osmane nuk pranoi të shpërdante parlamentin dhe nuk i përmbushi brenda afatit kërkesat e shtruara në memorandumun e Ferizajt, mbi 30 mijë kryengritës mësynë qytetin e Shkupit dhe pasi e çliruan vendosën rendin e qetësinë me një disiplinë të lakmueshme. Çlirimi i Shkupit, sipas autorit, ndonëse përbënte kulmin e aspiratave të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, nuk u shfrytëzua nga drejtuesit e kryengritjes për të zëvendësuar administratën osmane me atë shqiptare dhe për më tepër forcat osmane u lejuan të qëndronin në kalanë e qytetit dhe përreth tij.

Në vijim, autori provon se çlirimi i kryeqytetit të Vilajetit të Kosovës nga kryengritësit shqiptarë i shqetësoi shumë Portën e Lartë, Fuqitë e Mëdha, të interesuara për ruajtjen e status-quo në Perandorinë Osmane, dhe në veçanti shtetet e Aleancës Ballkanike. Duke trajtuar këto çështje, autori ndalet në hapin diplomatik të ndërmarrë, më 13 gusht 1912, nga ministri i Jashtëm austro-hungarez Leopold Berthold, që u propozoi Fuqive të Mëdha për të ndërmarrë një hap kolektiv pranë Portës së Lartë me qëllim që ta detyronin për të zbatuar politikën e decentralizimit, në përputhje me raportet e krijuara brenda perandorisë. Ndër të tjera, projekti do të çonte gradualisht edhe drejt krijimit të shtetit autonom shqiptar në kufijtë e tij etnikë, por ai nuk gjeti mbështetjen e Fuqive të Mëdha, sidomos të Francës, Rusisë dhe Anglisë.

Autori hedh poshtë edhe pohimet e qarqeve antishqiptare, sipas të cilave kryengritësit synonin të marshonin drejt Selanikut me qëllim që të lironin nga izolimi sulltan Abdyl Hamidin II dhe risjelljen e tij në fron dhe argumenton se këto pohime nuk kanë asnjë mbështetje në burimet relevante. Në të kundërtën, ai provon se drejtuesit e kryengritjes dhe të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare synonin të depërtonin drejt Velesit, Prilepit, Manastirit, Ohrit e Dibrës, për t'i nxitur shqiptarët e atyre krahinave t'i bashkoheshin kryengritjes, dhe kjo do të shërbente për të shënauar kufijtë e shtetit autonom shqiptar dhe për ta detyruar qeverinë osmane për të plotësuar kërkesat e shtruara në memorandumun e Ferizajt.

Interes paraqet vlerësimi i autorit se pas çlirimit të Prishtinës drejtuesit e kryengritjes aspironin për organizimin e Kongresit gjithëshqiptar, ku përfaqësuesit e të gjitha viseve shqiptare do të diskutonin për çështjen shqiptare dhe do të mermin vendime për mënyrën e zgjidhjes së saj. Por rrethanat e krijuara nuk bënë të mundur mbajtjen e këtij kongresi.

Në kapitull vend të rëndësishëm zënë bisedimet shqiptaro-osmane që u zhvilluan në Shkup midis drejtuesve shqiptarë me në krye Hasan Prishtinën dhe Komisionit qeveritar të kryesuar nga Ibrahim Pasha. Më 18 gusht 1912, pas debateve të gjata e shumë të tensionuara për pikat kontestuese, Ibrahim Pasha e informoi Hasan Prishtinën se qeveria osmane pranonte 12 nga 14 kërkesat e shtruara dhe siguronte se ato do të vlenin për të gjithë Shqipërinë. Këto premtime nuk i kënaqën të gjitha grupimet në radhët e kryengritësve, por H. Prishtina, ishte i vetëdijshëm për rrethanat e krijuara dhe për rrezikun që paraqiste Aleanca

Ballkanike që synonte gllabërimin e tokave shqiptare. Ai punoi për ta bindur grupimin kundërshtar për këtë rrezik, kërkoi largimin e kryengritësve nga Shkupi, i informoi drejtuesit e kryengritjes në Shqipërinë e Mesme e Jugore se kërkesat shqiptare ishin pranuar dhe kërkesa që t'i jepej fund kryengritjes. Ky qëndrim, nënvizon autori, shkaktoi pakënaqësi te një pjese e drejtuesve të kryengritjes (Isa Boletini, Riza Beu, Idriz Seferi, Salih Aga, Islam Spahiu etj.), të cilët u detyruan ta braktisnin Shkupin vetëm për shkak të bindjes e të autoritetit të H. Prishtinës. Mirëpo, ata para se të largoheshin nga qyteti i drejtuan një letër valiut të Kosovës, duke i dhënë një afat për përmbushjen e të gjitha kërkesave, në të kundërtën do të riktheheshin dhe jo për të shtruar kërkesa por për të realizuar pavarësinë e Shqipërisë.

Autori konkludon se marrëveshja shqiptaro-osmane që u nënshkrua në Shkup ishte nën nivelin e kërkesave programatike të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare të parashtruara në Greçë, në Junik dhe nga H. Prishtina në Prishtinë. Megjithatë, ai vëren se lëshimet për kryengritësit, për shkak të rrethanave të tensionuara në Ballkan dhe më gjerë, përbënin një hap të rëndësishëm, sepse ato ishin një bazë për sigurimin më pas të autonomisë së Shqipërisë. Në bazë të marrëveshjes, shqiptarëve u njihej e drejta e përdorimit të gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare, u garantohej e drejta e shkollimit në gjuhën amtare, se në administratë nëpunësit do të ishin shqiptarë, shërbimin ushtarak do ta kryenin në Rumeli, se në disa krahina do të zbatoheshin ligjet tradicionale shqiptare. Por, marrëveshja shqiptarëve edhe më tej nuk ua njihte statusin e kombit.

Sipas autorit, Kryengritja e përgjithshme antiosmane e vitit 1912 kishte një rëndësi të madhe sepse u shtri në shumë vise të Shqipërisë, në krye të saj u vu inteligjencia shqiptare dhe krerët tradicionalë e më në zë të krahinave shqiptare. Asaj iu bashkuan funksionarë shqiptarë të rangjeve të ndryshme në administratën osmane, oficerë e ushtarë, bejlerë të pasur, malësorë e fshatarë. Ajo, duke bashkuar në rradhët e saj shqiptarët myslimanë, ortodoksë e katolikë, forcoi unitetin e shqiptarëve dhe konsolidoi vetëdijen kombëtare e fetare të mbarë popullit. Në këtë kuptim ajo përbënte ngjarjen më të rëndësishme pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, sepse shqiptarët, siç kanë konstatuar edhe vëzhgues të huaj, edhe pse nuk arritën rezultate të mëdha, formuan elementin e nevojshëm, për “formësimin e kufijve të tyre politikë dhe etnografikë”. Ajo dëshmoi përpara Portës së Lartë dhe fqinjëve ballkanikë se Shqipëria nuk ishte një nocion gjeografik, por një tërësi etnike që duhej marrë në konsideratë në të ardhmen.

Kreu i fundit, “Lëvizja Kombëtare Shqiptare pas Marrëveshjes së Shkupit”, trajton veprimtarinë e Lëvizjes Kombëtare pas Marrëveshjes së Shkupit dhe deri në shpërthimin e Luftës së Parë Ballkanike. Mbi bazën e dokumentacionit të shfrytëzuar ai konkludon se në kohën kur filloi zbatimi në praktikë i marrëveshjes shqiptaro-osmane, qeveritë e shteteve ballkanike përshpejtuan përgatitjet për fillimin e operacioneve luftarake me arsyetimin se do luftonin për dëbimin e Perandorisë Osmane nga pjesa evropiane dhe për “çlirimin e vëllezërve” të tyre “të krishterë”. Në fakt, sipas autorit, aleatët ballkanikë luftuan për pjesëtimin midis tyre të pjesës evropiane të Perandorisë Osmane dhe për gllabërimin e tokave shqiptare.

Me këto pikësnyime shtetet e Aleancës Ballkanike, në tetor 1912, i shpallën luftë Perandorisë Osmane. ndërsa shqiptarët që ishin në një pozitë të vështirë u vunë në mbrojtje të tërësisë së trojeve të tyre. Këto objektiva u shpalosën qartë dhe hapur në mbledhjen që u mbajt në Shkup nga një pjesë e drejtuesve të Lëvizjes Kombëtare në Vilajetin e Kosovës, që ishte nga trevat më të rrezikuara. Në shpalljen (deklaratën) që u miratua me këtë rast drejtuar opinionit të brendshëm dhe të huaj, bëhej e qartë se shqiptarët po i rrëmbenin armët jo për të mbështetur e forcuar pushtetin osman në Ballkan, por për të mbrojtur tërësinë territoriale dhe lirinë e Shqipërisë.

Së fundi, autori i kësaj monografie që mbështetet mbi një bazë të gjerë burimore arrin në përfundimin se në kohën që ushtritë ballkanike, serbe, malazeze e greke, depërtuan thellë në tokat shqiptare, përfaqësues nga të gjitha viset e Shqipërisë u mbledhën, më 28 nëntor 1912, në kuvendin historik në Vlorë dhe shpallën Pavarësinë e Shqipërisë. Pavarësia e shtetit të ri shqiptar u pranua edhe me vendimet e Konferencës së Londrës, por jashtë kufijve të tij mbeti më tepër se gjysma e shqiptarëve.

Monografia e Prof. dr. R. Abdylit, siç vënë në dukje edhe recensentët e saj, përbën studimin më të plotë, një arritje të rëndësishme dhe njëherësh një kontribut me vlerë të çmueshme në historiografinë shqiptare për këtë periudhë. Ajo shërben si një themel i sigurt dhe si pikë e rëndësishme referimi për studiuesit që do të merren me trajtimin e këtyre problemeve në të ardhmen, si dhe për informimin e opinionit të gjerë publik e shkencor.

